

Turizmi në Shifra

2013-2017

Tiranë, më 31 Maj 2018: Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi për herë të parë një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi turizmin në Shqipëri.

Hyrjet e shtetasve të huaj në periudhën 2013-2017 janë rritur mesatarisht 12,0 %, ndërsa shpenzimet e turistëve të huaj (jo - rezidentët) në vendin tonë janë rritur mesatarisht 8,5 % për të njëjtën periudhë.

Në periudhën 2013-2017 daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur mesatarisht 7,2 %, ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit janë rritur mesatarisht 2,2 %.

Në periudhën 2013-2017, numri i vizitorëve që kanë vizituar kalatë dhe monumete ishte 621.061 persona, duke u rritur mesatarisht me 51,5 %.

Karakteristikat e turistëve të huaj në Shqipëri

Hyrjet nga rajoni i Evropës zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 92,4 % dhe janë rritur mesatarisht me 12,3 % gjatë periudhës 2013-2017.

Shtetasit e huaj që hyjnë në Shqipëri vijnë kryesisht nga: Kosova (34 %), Maqedonia (13 %), Greqia (10 %), Mali i Zi dhe Italia (7 % secili).

Në periudhën 2013-2017, numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi (ku përfshihen vizitorët që qëndrojnë të paktën një natë në hotel apo në struktura akomoduese të tjera, tek të afërmit, shtëpitë e tyre, etj.) janë rritur mesatarisht 13,0 %. Ndërsa numri i vizitorëve ditorë, për harkun kohor 2013-2017, është 1,3 milion, duke u rritur mesatarisht 39,0 %.

Tab. 1 Numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi dhe ditorë, në mijë

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Hyrjet gjithsej	3.256	3.673	4.131	4.736	5.118
Vizitorë me netë qëndrimi	2.857	3.341	3.784	4.070	4.643
Vizitorë ditorë	220	127	162	507	293

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe INSTAT

Karaktestikat kryesore të udhëtimeve të shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit

Në periudhën 2013-2017, 22,6 milion shtetas shqiptarë (rezidentë) kanë dalë jashtë vendit dhe kanë shpenzuar 854.547 milion lekë. Shpenzimet e rezidentëve për udhëtime personale zënë pjesën më të madhe mesatarisht 75,9 % dhe shpenzimet për udhëdhime biznesi dhe profesionale 24,1 % të shpenzimeve gjithsej.

Tab. 2 Tregues mbi shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Daljet ('000)	3.928	4.146	4.504	4.852	5.186
Shpenzime e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit (mln Lekë) nga të cilat:	165.583	178.154	165.135	166.148	179.527
Udhëtime Personale (mln Lekë)	116.024	133.959	116.010	117.330	129.526
Udhëtime Biznesi dhe profesionale (mln Lekë)	40.260	33.753	39.930	39.365	40.953
Shpenzime për Transport (mln Lekë)	9.299	10.442	9.195	9.453	9.048
Koha mesatare e qëndrimit (ditë)	7	7	7	10	8

Burimi: Banka e Shqipërisë

Rëndësia e turizmit në ekonomi

Në periudhën 2013-2017, pesha specifike mesatare e shpenzimeve të turistëve të huaj (jo -rezidentë) në vendin tonë, ndaj totalit të PBB, është 13,3 %, ndërsa pesha specifike mesatare e shpenzimeve të shtetasve shqiptarë jashtë vendit tonë ndaj totalit të PBB është mesatarisht 11,2 %.

Tab. 3 Treguesit makroekonomik, në %


Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Shpenzimet e turistëve të huaj (Inbound) mbi PBB	11,5	12,8	13,2	14,2	14,9
Shpenzimet e turistëve vendas jashtë (Outbound) mbi PBB	11,6	12,0	10,9	10,6	11,0
Bilanci i turizmit (shpenzimet brenda vendit) minus jashtë vendit) mbi PBB	0,0	0,8	2,3	3,6	3,9

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kapacitetet akomoduese në Shqipëri

Në vitin 2016, në gjithë vendin funksionuan 1.242 struktura akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra). Numri gjithsej i dhomave në këto struktura ishte 17.692 dhe shtretërit ishin 41.376 mijë. Gjatë viteve 2013-2016, numri gjithsej i strukturave akomoduese (që funksiononin gjatë periudhës) u rrit mesatarisht me 20,3 % dhe numri i shtretërve në to u rrit me 13,3 %.

Fig. 1 Kapaciteti i njësive akomoduese në vendin tonë, 2012-2016



Për të lexuar publikimin e plotë mbi "Turizmi në Shifra, 2013-2017" konsultohuni me linkun:

<http://instat.gov.al/al/publikime/librat/2018/turizmi-n%C3%AB-shifra/>

Metodologjia

INSTAT realizoi botimin turizmit në shifra në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë. Ky botim përmban statistika nga sektorë të ndryshëm të dy institucioneve.

Statistikat përfshijnë gjithë shtetasit e huaj dhe Shqiptarë që vizitojnë Shqipërinë. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Për më shumë informacion metodologjik referohuni link-eve:

Statistikat e Turizmit

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/turizmi/>

Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-strukturore-t%C3%AB-nd%C3%ABmarrjeve-ekonomike/>

Lejet e ndërtimit

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/nd%C3%ABrtimi/>

Banka e Shqipërisë

https://www.bankofalbania.org/web/Statistika_230_1.php

Përkufizimet kryesore

Hyrjet dhe daljet përfshijnë të gjitha hyrjet e daljet të personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet është një një koncept që i referohet të gjitha hyrjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Turizmi përfshin aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende të ndryshme nga vendi i qëndrimit të tyre të zakonshëm për një periudhë jo më të gjatë se një vit kalendarik dhe qëllimi i këtij udhëtimi është kohë e lirë, biznes e të tjera.

Vizitor përfaqëson një "person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtariefitimprurëse". Të gjithë udhëtarët që përfshihen në turizëm janë vizitorë. Termi "vizitor" përfaqëson konceptin bazë për gjithë sistemin e statistikave të turizmit. Termi "vizitor" për qëllime të statistikave dhe dhe në perputhje me format e turizmit klasifikohet më pas në dy kategori: "turistë (vizitorë me neteqendrim)" dhe "vizitorë ditorë"

Vizitor ditor quhet një vizitor i cili nuk kalon natën në një strukturë hoteliere në vendin që ai viziton.

Rezident quhet personi që ka banuar në këtë vend të paktën 12 muaj.

Jo rezident quhet personi nuk ka banuar në vendin e vizituar 12 muaj radhazi ose më shumë.

Neteqendrim i referohet numrit të netëve të kaluara nga rezidentët dhe jo-rezidentët në hotele brenda vendit.